



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 629/1 Prot

Tiranë, më 01.06.2021

V E N D I M

Nr.61, datë 01.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë të pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi *** , në lidhje me rënien e shkakut të pezullimit nga shërbimi civil dhe moskryerjen e veprimeve përkatëse për kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 804 prot., datë 29.10.2020, nëpunësi doganor ***** , ka parashtruar pretendimin se, megjithëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka pushuar akuzën, e cila shërbeu si shkak për marrjen ndaj tij të masës së pezullimit nga shërbimi civil, gjë që do të thotë se shkak i pezullimit ka rënë, institucioni punëdhënës nuk ka vepruar për kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që, kërkuesi ***** , ka kryer detyrën “Doganier Klasifikim/Vlerësim/Kontroll Fizik, Zyra e Operacioneve Doganore”, në Degën e Doganës Qafë-Thanë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Gjatë kryerjes së detyrës si doganier në degën e doganës Qafë-Thanë, ndaj tij ka nisur një ecuri disiplinore, me pretendimin se ka shkelur rëndë disiplinën në punë, shkelje për të cilat filloi edhe ndjekja penale. Komisioni i Disiplinës i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me Vendimin e

Ndërmjetëm nr. 27427/3, datë 18.11.2018, në bazë të pikës 1/ë, të nenit 54 dhe pikës 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka vendosur pezullimin e tij nga detyra, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Aktualisht, pas kryerjes së verifikimit të pretendimit të nëpunësit në fjalë, konstatohet që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me Vendimin nr. (298) – 118, datë 16.6.2020, ka vendosur miratimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e akuzës për personin nën hetim ***** , vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 2.7.2020.

Me daljen e këtij vendimi, kërkuesi nëpërmjet një kërkesë të paraqitur në dt.13.8.2020, ka parashtruar para njësisë të burimeve njerëzore të institucionit, se shkak i pezullimit ka rënë, prandaj bazuar në pikën 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duhet të vendoset heqja e masës së pezullimit dhe kthimi në vendin e mëparshëm të punës. Në kushtet kur institucioni nuk ka reagu, kërkuesi në fjalë ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe rikthimin e tij në vendin e punës.

Ndërkohë, gjatë kryerjes së procesit të hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri, u vu në dijeni të faktit se, Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i ndodhur përballë rrethanave të reja të sipërpërmendura, e ka rishikuar çështjen disiplinore për nëpunësin ***** , dhe me Vendimin Përfundimtar të tij nr. 4852, datë 10.3.2021, ka vendosur :1) *Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e nëpunësit ******; 2) *ndërprerjen e ecurisë disiplinore*; 3) *rikthimin në një vend vakant, në detyrën Doganier, në Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore, pranë Degës Doganore Korçë*, si dhe 4) *pagesën e detyrimeve sipas pikës 4, të nenit 56, të ligjit për nëpunësin civil*.

Mbi këtë bazë, në zbatim të pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të pikës 17, shkronja “b”, Kreu II, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 1898/1, datë 14.4.2021, ka vendosur transferimin e përhershëm pas përfundimit të periudhës së pezullimit të nëpunësit doganor ***** , në pozicionin *“Doganier në Zyrën e Mbikëqyrjes Doganore”*, në Degën Doganore Korçë, pozicion të cilin ai e ka pranuar.

Nga sa parashtruam më sipër, arrihet në përfundimin se në këtë rast, si Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ashtu dhe njësia përgjegjëse, kanë plotësuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, prandaj bazuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, duhet të vendoset përfundimi i kësaj procedure administrative dhe arkivimi i çështjes.

Megjithatë, është e pajustificuar koha e gjatë (*prej afro 8 muaj*), që ka kaluar nga momenti i vënies në dizeni të institucionit për rrethanat e reja të krijuara (dt. 13.8.2020) deri në momentin e daljes së aktit të rikthimit në punë të nëpunësit në fjalë pas rënies së masës së pezullimit (dt. 14.4.2021), prandaj do të ishte me vend që, si njësisë së burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ashtu dhe njësisë përgjegjëse, ti tërhiqet vëmendja që në raste të ngjashme, të veprohet sa më shpejt të jetë e mundur, që të minimizohen si dëmet psikologjike tek punonjësit e ndëshkuar padrejtësisht, ashtu dhe dëmet financiare që vijnë nga pagesat e pagës, pa kryer punë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 804 prot., datë 29.10.2020, paraqitur prej nëpunësit ***** , në lidhje me pretendimin e tij për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, pas rënies së shkakut të pezullimit dhe meqënëse në veprimet e njësisë përgjegjëse dhe njësisë të burimeve njerëzore të institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk gjenden elementë kundërligjshmërie, çështja të arkivohet.

Të mbahet parasysh në të ardhmen, vërejtja e bërë në pjesën arsyetuese të vendimit, për rritjen e shpejtësisë së reagimit, për rivendosjen e të drejtave të shkelura të nëpunësve.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

